



Qendra për Politika dhe Avokim Center for Policies and Advocacy

Projekti: “Për një mjedis të pastër”

Komuna: GJILAN

Periudha: Shtator-Dhjetor, 2009



Botues:



Qendra për Politika dhe Avokim
Center for Policies and Advocacy

Hartues të Raportit:

Tafë Veselaj dhe Aferdita Maliqi

Hulumtues në terren:

Milaim Morina
Drilon Dobruna
Valentina Hyseni
Albulena Berisha

Redaktore:

Shqipe Pantina

Mbështetur nga:



"Ky projekt u financua përmes grantit të Departamentit të Shtetit të SHBA-ve. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit të SHBA-ve."

I. Hyrje

Mjedisi dhe mbrojtja e tij janë ndër çështjet më shqetësuese, por edhe më prioritetet, të politikbërësve në të gjithë botën, ndërkohë që posaçërisht ngrohja golbale po bëhet një shqetësim serioz për globin tokësor.

Në Kosovë, çështja e mjedisit, për fat të keq, nuk ka qenë për një kohë të gjatë në listën e prioritetëve të politikbërësve. Edhe sot, mbrojtja e mjedisit ende nuk zë hapësirën dhe rëndësinë e duhur në agjendat e politikbërësve qoftë në nivelin qendror, por veçanërisht në nivelin lokal.


Organizata Joqeveritare Qendra për Politika dhe Avokim (QPA), në raportin e saj për Komunën e Gjilanit, pas hulumtimit që ka bërë, gjetjeve dhe debatit me përfaqësuesit e partive politike, gjatë fushatës parazgjedhore të zgjedhjeve lokale të 15 nëntorit 2009, prezanton një përmbledhje të shkurtër për gjendjen e mjedisit në këtë komunë, infrastrukturën ligjore që rregullon fushën e mjedisit, qasjen e partive politike për çështjet mjedisore dhe në fund rekomandimet që janë dalë nga tryeza e organizuar për mjedisin, e që kanë synim përmirësimin e kësaj gjendjeje.

Raporti është pjesë e projektit “Për një mjedis të pastër”, i cili është mbështetur nga Ambasada e SHBA-ve në Prishtinë, të cilën e falënderojmë përzemërisht. Po ashtu, QPA falënderon thellësisht përfaqësuesit e partive politike të Komunës së Gjilanit, si dhe qytetarët, të cilët kanë kontribuar me komentet dhe rekomandimet e tyre.

Veçanërisht falënderojmë përfaqësuesit e partive politike, si Jashar Ramadani kandidat për kryetar komune nga Lidhja Demokratike e Dardanisë, Veton Uka kandidat për Asamble nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Arianit Sllamniku kandidat për kryetar komune nga Partia e Drejtësisë, të cilët kanë prezentuar prioritetet që partitë parashohin në fushën e ambientit nëse fitojnë zgjedhjet lokale.

QPA po ashtu thellësisht falënderon ata që bënë të mundur jo vetëm hartimin e këtij raporti, por edhe gjithë zbatimin e projekti “Për një mjedis të pastër”: Menaxheren e Projektit, Afërdita Maliqi, ekspertin për çështje mjedisore, Tafë Veselaj, si dhe hulumtuesit Drilon Dobruna, Milaim Morina, Valentina Hyseni dhe Albulena Berisha.

II. Komuna e Gjilanit - karakteristikat dhe veçoritë



1

Gjiçani ka sipërfaqe prej 515 km², me 63 vendbanime dhe 54 komuna kadastrale. Numri i përgjithshëm i banorëve është 133.724, me dendësi 259 banorë një kilometër katror. Në zonën urbane jetojnë 79.898 banorë, ndërsa pjesa tjetër në viset rurale². Pra, gjysma e popullatës jetojnë në qytet, që tregon për ndikim të theksuar në çështjet mjedisore.

Gjiçani ka një traditë të gjatë industriale, ku veprojnë disa kompani të mëdha siç janë: Industria e Tekstilit, Industria e Duhanit, Ndërmarrja Shoqërore "Çeliku", Ndërmarrja Shoqërore "Kualiteti", "Jugoterm", Ndërmarrja Shoqërore IBGJ (Industria e baterive), Ndërmarrja Hidro-Ndërtimore Industriale "Morava e Binçës".

Po ashtu, janë regjistruar 3.960 biznese private, duke punësuar 8.500 persona³ dhe të gjitha këto aktivitete ushtrojnë ndikim të caktuar në mjedis.

¹ GIS-AMMK-MMPH

² *Enti i Statistikave të Kosovës, dhjetor 2002*

³ *Strategjia zhvillimore lokale, 2008, Gjiçan*

II.1. Gjendja aktuale e mjedisit

Në bazë të hulumtimeve dhe vlerësimeve të bëra, Gjilani ballafaqohet me probleme mjedisore të ndryshme siç janë: mungesa e ujit të pijes, mungesa e trajtimit të ujërave të zeza, menaxhimi jo i mirë me mbeturina, menaxhimi jo i mirë i tokës bujqësore, ndërrimi i destinacionit të shfrytëzimit të tokës bujqësore, urbanizimi, shfrytëzimi i inerteve nga shtretërit e lumenjve, prerja e pyjeve dhe mungesa e ripyllëzimeve, hapësirat e pamjaftueshme të gjelbëruara në qytet, mungesa e sistemit të monitorimit të medimeve mjedisore etj.

Rrethina e Gjilanit është e pasur me xehe (*hekur e leucit*) dhe me burime minerale (Nasalë, Pidiq, Kmetoc, Pogradë, Perlepnice). Gjilani dallohet nga komunat tjera me një pedologji më homogjene të tokës⁴. Mirëpo, përkundër posedimit të këtyre xeheve dhe burimeve minerale, sektori i minierave ende nuk është i zhvilluar.

Bujqësia dhe Pylltaria: Prej gjithsej 51.500 hektarë sipërfaqe tokësore sa ka Komuna e Gjilanit me pyje dhe tokë pyjore janë të përfshira 26,560 ha (51.6%), ndërsa me tokë bujqësore 24.940 (48.4%).

Pjesa më e madhe e tokës përbëhet nga dheu i mirë, i thellë dhe pjellor, duke i dhënë Gjilanit një mundësi të vërtetë për intensifikimin e bujqësisë. Prandaj, bujqësia është aktiviteti kryesor në qendrat rurale, duke prodhuar kryesisht drithëra dhe foragjere⁵.

Vetëm 4.8 % e sipërfaqes së përgjithshme të tokës së kultivuar bujqësore e regjionit të Gjilanit është nën ujë, që zënë vendin e fundit si regjion në Kosovë⁶.

Aktualisht ekzistojnë 3200 ferma të vogla dhe 48 ferma të mëdha. Bujqësia është një ndër fushat ekonomike që ndikon në mjedis, duke bërë spërkatjen e bimëve me pesticide, herbicide dhe efekti nga plehrat kimike.

Problem i rëndësishëm është ndërrimi i destinimit të përdorimit të tokave bujqësore, prerja dhe dëmtimi i pyjeve, dhe mungesa e ndonjë programi të ripyllëzimit.

Infrastruktura rrugore: Përfshin 122 km rrugë të asfaltuara, me një tendencë të shtimit të rrugëve nëpër vendet rurale⁷. Numri enorm i automjeteve nëpër qytet është shkaktar i ndotjes së madhe të mjedisit.

⁴ <http://www.komuna-gjilani.org/>

⁵ Strategjia zhvillimore lokale, 2008, Gjilan

⁶ Anketa e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore, ESK 2007

⁷ Strategjia zhvillimore lokale, 2008, Gjilan

Për më tepër, nuk ka monitorim të emisioneve të ajrit e as monitorim të cilësisë së ajrit. Zgjerimi i infrastrukturës rrugore dhe transporti gjithashtu bartin me vete efektet negative për mjedisin, për shkak të lirit të gazrave dhe zënies së sipërfaqeve të tokës me asfalt.

Uji i pijes dhe ujërat e zeza: Lumi Morava e Binçës është lumi më i madh i kësaj komune, por ka edhe lumenj të tjerë që janë të rëndësishëm siç është lumi i Përlepnicës, mbi të cilin është ndërtuar penda me qëllim të ujit të pijshëm.

Kjo pendë nuk është e mjaftueshme për furnizim të qytetarëve me ujë të pijes, prandaj një pjesë e tyre shfrytëzojnë edhe ujin nga pusët. Ndërsa, vendet rurale vetëm 10% kanë qasje në ujë të pijshëm. Menaxhimin e ujit të pijshëm e bën Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Hidromorava” Sh.A.⁸

Qyteti ka një problem të madh me kundërmimin që vjen nga ujërat e zeza si pasojë e mbulimit të shtratit të lumenjve Mirusha dhe Stanishorka dhe derdhja e ujërave të zeza në to. Kundërmimi përshkon tërë qytetin, por më shumë kanë probleme banorët që shtrihen përkaj rrugës për në fshatin Malishevë, si dhe banorët në pjesën periferike që njihet si “Zabeli i Sahitagës”.⁹

Ndërsa, në vendet rurale vetëm 12 % e tyre kanë qasje në sistemin e kanalizimit¹⁰. Të gjitha ujërat e ndotura urbane derdhen në lumenj, për shkak se nuk kanë ndonjë impiant të pastrimit të ujërave të zeza, ndërkaq kjo i dëmton lumenjtë. Gjithashtu, problem tjetër është edhe dëmtimi i shtratit të lumenjve nga shfrytëzimi i inertëve nga shtretërit e lumenjve.

Menaxhimi i mbeturinave: Është një nga problemet më të mprehta mjedisore për këtë komunë. Kemi lloje të ndryshme të mbeturinave si ato komunale, mbeturinat e ndërtimit, mbeturinat medicinale, automjetet mbeturinë, gomat mbeturinë, vajrat mbeturinë, bateritë e hedhura¹¹.

Sasia e deponimit të mbeturinave për banor është 142 (kg/vit), ndërsa sasia e përgjithshme e mbeturinave 52,120.75 ton. Kompania regjionale “Higjiena” është kompania që bën grumbullimin, bartjen dhe deponimin e mbeturinave, ndërkohë që ekzistojnë edhe disa kompani që bëjnë trajtimin e mbeturinave në këtë komunë: “Bosfor” që merret me grumbullimin e hekurit, aluminit, mesing, bateri me kapacitet 10 T/muaj, po ashtu edhe “Hekurishte” merret me grumbullimin e mbeturinave hekur, alumin, mesing, bateri.

Deponia Regjionale që gjendet në Gjilan, me madhësi 24 ha, përfshinë komunat: Gjilan, Kamenicë, Viti, Novobërdë, Kaçanik, Shtime dhe Ferizaj. Gjendja në këtë deponi nuk është e mirë, sistemi i pompimit nuk funksionon rregullisht dhe si pasojë e kësaj bëhet përzierja e ujërave sipërfaqësore me ato të deponisë dhe për këtë ka ankesa të shpeshta nga banorët vendas.

⁸ Strategjia zhvillimore lokale, 2008, Gjilan

⁹ Gjilani – raporti komunal; Instituti për Studime të Avancuara GAP, 2009

¹⁰ Strategjia zhvillimore lokale, 2008, Gjilan

¹¹ Gjendja e mbeturinave në Kosovë 2008, AKMM Prishtinë

Banorët që jetojnë në anën e poshtme të kësaj Deponie rajonale janë të prekur nga efektet e saj jo vetëm nga kundërmimi i erës, por edhe nga kontaminimi i ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor. Shumë burime ujore, që deri para ndërtimit të deponisë janë shfrytëzuar nga banorët vendas, tani janë të papërdorshme. Andaj, Deponia regjionale ka shkaktuar probleme të mëdha në mjedis me një efekt shumë të gjerë.

Natyra, Turizmi dhe Rekreacioni: Natyra është mjaftë e pasur me lloje bimore dhe shtazore të egra, sidomos Malet e Karadakut dhe ato të Zhegovcit. (Nuk ka ndonjë hulumtim të rëndësishëm të këtij komponenti).

Në vitin 2002 është bërë rekognosimi i vlerave të natyrës së Gjilanit dhe janë propozuar 16 zona¹² të natyrës për mbrojtje, por ato kanë mbetur në procedim e sipër nga Kuvendi Komunal. Në Komunën e Gjilanit nuk ka sipërfaqe të mjaftueshme të gjelbëruar, megjithatë vlen të përmendet se Parku i qytetit mirëmbahet mire.

Zona potenciale për zhvillimin e turizmit janë Malet e Karadakut, Zhegovcit, Kulla e Pogragjës, Shpella në Bresalc, burimi termomineral në Doberqan etj.

Peshkimi dhe gjuetia si veprimtari sportive janë të organizuara përmes shoqatave. Peshkimi është një veprimtari sportive jo shumë e zhvilluar dhe zhvillohet në Liqenin e Livoqit, atë të Përlepnicsës etj. Gjuetia e kafshëve të egra është e organizuar përmes shoqatës “Agim Ramadani”, por nuk dihet për fondin e kafshëve të egra.

II.2. Infrastruktura ligjore në fushën e mjedisit

Kuvendi i Kosovës deri më sot ka miratuar ligje që rregullojnë mbrojtjen e mjedisit dhe natyrës dhe ato që ndërlidhen me ndikimet në mjedis. Pothuaj se janë 32 ligje të tilla, kurse ligjet më të rëndësishme për mjedisin që zbatohen në Komunën e Gjilanit janë:

- Ligji për mbrojtjen e mjedisit
- Ligji për ujërat e Kosovës
- Ligji për mbeturinat
- Ligji për vetëqeverisje lokale
- Ligji për mbrojtjen e natyrës
- Ligji për planifikimin hapësinor
- Ligji për pyjet e Kosovës
- Ligji për gjuetinë
- Ligji për peshkatari dhe akuakulturë, etj.

Kuvendi Komunal ka miratuar Strategjinë zhvillimore komunale (Qershor 2008) dhe është duke e punuar Planin lokal të veprimtimit për mjedis.

¹² Raport i Rekognosimit të vlerave të natyrës në Komunën e Gjilanit, Instituti i Natyrës, Prishtinë 2002

II.3. Institucionet përgjegjëse dhe mekanizmat për mbrojtjen e mjedisit

Asambleja Komunale e Gjilanit është institucioni më i lartë vendimmarrës dhe Drejtoria për urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit. Në kuadër të kësaj drejtorie vepron zyrtari për mjedis, i cili së bashku me inspektorin për mjedis nuk mund t'i mbulojnë kërkesat e mbrojtjes së mjedisit në këtë komunë.

Në kuadër të Asamblesë Komunale vepron Komiteti për planifikim urban dhe mbrojtje të mjedisit. Gjithashtu, edhe Drejtorati për bujqësi dhe pylltari është strukturë që rangon me këtë problematikë.

Në Komunën e Gjilanit shoqëria civile është mjaftë e organizuar. Ekzistojnë një numër relativisht i madh i OJQ-ve, të cilat merren me aktivitete të ndryshme nga fusha të ndryshme.

Për shkak se regjistrimi i OJQ-vë nuk bëhet në komunë, nuk ka të dhëna të sakta lidhur me numrin dhe profilin e OJQ-ve që veprojnë në Komunën e Gjilanit, por sidoqoftë janë diku rreth 15 OJQ, që prej tyre ka edhe OJQ mjedisore, siç janë: “Paqja me Natyrën”, “Agroferma”, “Ekosistemi”, Gurëbardhi, Gjilani dhe Blini (Shoqata e bletarëve), “Agim Ramadani” (Shoqata e gjuetarëve), “Agrounioni”, “Liria” (Shoqata e grave), “Iniciativa Rurale”, “KCIC” etj.

III. Platformat politike të partive politike për çështjen e mjedisit

Subjektet politike në këtë komunë nuk kanë ofruar programe politike, të cilat përfshin mjedisin dhe prioritet e saj. Por, edhe pse në mungesë të ofrimit të programeve, këto subjekte politike në një debat të organizuar në këtë qytet kanë shpalosur dhe prezantuar prioritetet e tyre për zgjidhjen e problemeve mjedisore.

Debati “Për një mjedis të pastër” në Komunën e Gjilanit është mbajtur më 17.10.2009, ku kanë marrë pjesë disa nga partitë politike që veprojnë në këtë komunë si dhe OJQ, biznese dhe qytetarë.

a) Partia e Drejtësisë (PD) në debat është përfaqësuar nga z Arianit Sllamniku, cili prezantoi problemet ekzistuese dhe sfidat me të cilat përballet komuna. Sipas tij, problemet mjedisore janë të shumta si: degradimi i lumenjve, hedhja e mbeturinave, mungesa e vetëdijesimit të qytetarëve dhe mosbashkëpunimi me shoqërinë civile.

Sllamniku ka thënë se partia e tij si prioritet për zgjidhjen e problemeve ambientale në këtë komunë ndër të tjera ka edhe aplikimin e një metode më të mirë të mbrojtjes së lumenjve dhe mirëmbajtjen e tyre, zhvillimin dhe mbrojtjen e florës dhe faunës, vetëdijesimin e

qytetarëve për mbrojtjen e ambientit, bashkëpunimin me shoqërinë civile për iniciativat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, si dhe mbrojtjen e pyjeve dhe ekosistemeve etj.

b) Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) në debat është përfaqësuar nga z. Veton Uka, i cili gjithashtu paraqiti problemet ekzistuese të mjedisit në këtë komunë. Sipas tij, problemet janë të mëdha, duke filluar nga menaxhimi me mbeturinat, ndotja e ujërave, edukimi mjedisor për qytetarët, degradimi i tokave dhe një seri problemesh tjera evidente.

AAK tejkalimin e problemeve mjedisore të Komunës së Gjilanit i ka paraparë në bazë të një plani njëvjeçar, sipas të cilit objektivat dhe prioritetet në fushën e ambientit do të jenë si: menaxhimi më i mirë i mbeturinave dhe riciklimi i tyre, plani operativ për menaxhimin e mbeturinave në komunë, trajtimi i ujërave të zeza, menaxhimi me tokat bujqësore, formimi i një inspektorati për vlerësimin e tokave bujqësore, katalizatorët për automjete me qëllim të evitimit të ndotjes së ajrit etj.

c) Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD) është e përfaqësuar nga z. Jashar Ramadani. Prezantimi i platformës politike për mjedis nga kjo parti nuk kishte ndonjë ndryshim të madh në krahasim me subjektet tjera.

Ramadani tha se ndër problemet mjedisore që rëndojnë në Komunën e Gjilanit janë ekosistemi i rënduar, degradimi i lumenjve, keqmenaxhimi i mbeturinave, industria, gurëthyesit etj. Daljen nga kjo situatë Ramadani e sheh nëse do të kishte një menaxhim më të mirë të mjedisit nga ana institucionale.

Ai premtoi së nëse LDD do të fitojë në zgjedhjet komunale si prioritate për zgjidhjen e problemeve mjedisore do të ketë ruajtjen e ekosistemit, mirëmbajtjen dhe ruajtjen e lumenjve nga degradimi dhe ndotja, që përgjegjësia institucionale të jetë në nivelin më të lartë, menaxhimi më i mirë me mbeturinat, etj.

Në debat morën pjesë edhe disa OJQ, si “Agro-eko”, OJQ “Landsdowne”, OJQ “Agro far” dhe OJQ “Paqja me natyrën”.

Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile në debat ishte një kontribut i madh për arsye se u paraqiten problemet mjedisore në komunë, veprimet që duhen të ndërmerren nga institucionet qeverisëse komunale dhe faktorët ndotës.

Gjithashtu, ato shprehen shqetësimin e tyre se si anashkalohen OJQ-të nga institucionet lokale gjatë proceseve të ndryshëm në çështjen e mjedisit.

OJQ-të kanë prezantuar objektivat e tyre për mjedis, por njëherit shprehen edhe nevojat dhe prioritetet për fushën e mjedisit që duhen të realizohen në Komunë nga ana institucionale dhe masat që duhen të merren.

IV. Rekomandimet

Rekomandimet e dala nga tryeza “Për një mjedis të pastër”:

- Katalizatorët për automjete me qëllim të evitimit të ndotjes së ajrit. (Kjo do të ndihmonte që të reduktohen në masë të madhe gazrat që lirohen nga automjetet, të cilat potencialisht kontribuojnë në masë të madhe në ndotjen e ambientit).
- Ndërtimi i një impianti për trajtimi e ujërave të ndotura. (Një impiant i tillë do të kishte konsekuenca të mëdha në pastrimin e ujit dhe evitimin e ndotjes së lumenjve, tokës dhe ajrit, pasi që ujërat e zeza në shumicën e rasteve derdhen në lumenj).
- Mirëmbajtja dhe ruajtja e lumenjve si dhe zhvillimi dhe mbrojtja e florës dhe faunës.
- Ndërtimi i një fabrike për riciklimin e mbeturinave. (Ndërtimi i kësaj fabrike do të ndihmonte në seleksionimin e mbeturinave dhe do të evitoheshin deponitë e egra, të cilat janë ndër ndotësit më të mëdhenj të mjedisit).
- Bashkëpunimi me shoqërinë civile për iniciativat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit në ngritjen e vetëdijes së qytetarëve për mbrojtjen e ambientit.
- Menaxhimi me tokat bujqësore dhe mbrojtja e pyjeve dhe ekosistemeve. (Komuna duhet të formojë inspektoratin për vlerësimin e tokave bujqësore dhe të ketë parasysh mbrojtjen e tokave bujqësore me rastin e lëshimit të lejeve të ndërtimit dhe lejeve urbanistike).

Të bashkangjitura anekset:

- 1. Platformat politike**
- 2. Mbulimi medial**

1. Platformat e Partive Politike

1.1 Platforma politike e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK)

Pjesë të shkëputura nga platforma politike e Lidhjes Demokratike e Kosovës, dega në Gjilan.

Gjilani me planifikim profesional dhe kriteret urbanistike, synohet të ketë një ambient të favorshëm për ndërtim dhe zhvillim hapësinor.

Lidhja Demokratike e Kosovës, kujdes të veçantë i kushton krijimit të kushteve për një mjedis ekologjik, infrastrukturë moderne urbane dhe rurale si dhe garanton ruajtjen dhe kujdesin e pronës komunale dhe asaj private.

Lidhja Demokratike e Kosovës, ndër prioritetet e saja të para do t'i ketë:

- Ridizajnimin e planit zhvillimor komunal
- Hartimin e planit zhvillimor urban
- Hartimin e planeve rregullative.

Me hartimin e këtyre planeve, do të përmbushet një prej elementeve kryesor për ta ri-planifikuar qendrën e qytetit dhe pjesë të caktuara të qytetit. Një nga prioritetet tona do të jetë hartimi i Planit Rregullativ, në hapësirën veri-lindore të qytetit, ku ka qenë i shtrirë kampi “Monteith”.

Gjithashtu në varshmëri me gjendjen ekzistuese do të bëjmë rishikimin dhe do t'i qasemi modifikimit të Planit Detaj Urbanistik, brenda unazës qarkore dhe në vetë qendrën e qytetit.

Lidhja Demokratike e Kosovës, do të hulumtojë mundësinë e qasjes së ndryshimit të PDU-së, edhe sa i përket çështjeve të gabaritit dhe katësisë të objekteve ndërtimore në Komunën e Gjilanit, natyrisht duke përmbushur të gjitha parakushtet që dalin nga dispozitat ligjore që mbulojnë këtë segment me rëndësi.

Inkurajojmë grupet e interesit të fillojnë me projektet e tyre, të cilat mund të trajtohen me prioritet në punën e Kuvendit Komunal, për t'i dhënë mbështetjen ligjore dhe për t'i inkorporuar ato në kornizën e PZHK.

Gjithsesi pjesë e angazhimeve tona do të jetë trajtimi i vendbanimeve informale, ndërsa realizimi do të bëhet përmes programeve të implementimit dhe programeve të rregullimit, të cilat do të jenë në harmoni me rregullativën ligjore dhe rregulloreve në fuqi.

Gjithashtu, LDK është e interesuar për bashkërenditjen ndërtimore në hapësirat dhe ngastrat ndërtimore. Infrastrukturë të rregulluar urbane dhe rurale, me ambient të pastër dhe të shëndetshëm, që rritë kualitetin e jetesës së qytetarëve dhe përforcon aktivitetet e biznesit në komunë dhe më gjerë.

Lidhja Demokratike e Kosovës, kujdes të veçantë i kushton mirëmbajtjes së projekteve të realizuara si dhe konform planeve rregullative do ta orientojë shtrirjen e infrastrukturës publike përmes:

- Shtrirjes së rrjetit të kanalizimit dhe sigurimit të ujit të pijshëm në të gjitha zonat,
- rikonstruimit të rrjetit të kanalizimit dhe ujësjellësit,
- Asfaltimit dhe mirëmbajtjes së përhershme të infrastrukturës rrugore,
- Zgjerimit të rrjetit të ndriçimit publik edhe në zonat rurale dhe mirëmbajtja e tyre,
- Rregullimin dhe mirëmbajtjen e objekteve të infrastrukturës publike (objektet komunale, teatrot, bibliotekat, ambulancat, shkollat, etj.) dhe të hapësirave publike (parqet, sheshet, tregjet, varrezat, parkingjet, terrenet sportive etj.),
- Përmirësimi i infrastrukturës dhe objekteve që rezultojnë me:
- Kursimin e energjisë dhe kanë ndikime pozitive në ndikimet ambientale – ngrohje globale,
- Rregullim të trafikut – sinjalizimet, parkingjet dhe kahet e lëvizjeve, duke inkorporuar kushtet teknike për lëvizje të personave me aftësi të kufizuar,
- Rregullim të transportit urban dhe periferik,
- Zvogëlim të humbjeve të ujit të pijshëm dhe hulumtim i kapaciteteve të reja,
- Krijim të mekanizmave për menaxhim dhe riciklim të mbeturinave,
- Krijim të impiantit për përpunimin e ujërave të zeza.

Administrimi i tokës dhe pasurisë publike, garantimi i pronës private dhe menaxhimi i informacioneve pronësore, menaxhimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave të banimit kolektiv, do të jenë prioritet bazë të Lidhjes Demokratike të Kosovës në Gjiilan.

Duke ju përmbajtur infrastrukturës ligjore, synojmë realizimin e këtyre objektivave:

- Hartimin e një strategjie të re të banimit,
- Azhurimi dhe rindërtimi i përhershëm i të dhënave kadastrale,
- Funksionalizimin e Këshillave shtëpiak,

- Fasadimi i objekteve publike të banimit kolektiv,
- Ssigurinë e pronësisë si çështje qenësore për një politike efektive banesore,
- Përgjegjësia e përgjithshme për menaxhimin e informacioneve pronësore, vlerën dhe shfrytëzimin e tokës,
- Siguria për kredi,
- Zhvillimi dhe monitorimi i tregut të tokës,
- Zvogëlimi i kontesteve për tokën,
- Ndihmesa dhënë reformave agrare,
- Integrimi i të dhënave–informatave,
- Hartimi i sistemit informativ gjeografik-GIS.

Debat me kandidatet e tapanit ne zgjedhjet e nentorit
për ambientin

LDD-ja, PD-ja, AAK-ja dhe AKR-ja premtojnë trajtim të ujërave të zeza

KOHA
E KRAJES

NEXHAT BUZUKU

GJILAN, 18 TETOR - Disa nga kandidatët për kryetar të Gjilanit, këshilltarë komune që garojnë në zgjedhjet lokale të 15 nëntorit, kanë shpalosur vizionet e tyre dhe platformat parazgjedhore lidhur me ambientin në debatin e organizuar nga Qendra për Politikë dhe Avokim (QPA), e mbështetur nga Ambasada amerikane në Prishtinë, me temë: "Për një ambient të pastër".

Përfaqësues të LDD-së, AKR-së, AAK-së dhe PD-së kanë premtuar trajtim të ujërave të zeza, politika konkrete mjedisore e bujqësore dhe ndaljen e migrimit drejt zonave urbane. Kandidati për kryetar të Gjilanit nga LDD-ja, Jashar Ramadani, ka theksuar se problemi prioritar mjedisor në Gjilan është trajtimi i ujërave të zeza dhe krijimi i hapësirave më të mëdha të gjelbëruara. Ndërsa ka përmendur problemin e lumit Mirusha dhe ndotjen që bëhet prej tij.

Ndërkaq, Arjan Sllamniku, kandidat për kryetar të Gjilanit nga PD-ja, ka shprehur bashkëpunimin e pamjaftueshëm të pushtetit me shoqërinë civile. Ai ka theksuar se në të ardhmen duhet të rritet ky bashkëpunim dhe pushteti vendor duhet të ofrojë më shumë mbështetje edhe financiare për OJQ-të, që merren me mbrojtjen e mjedisit. Kandidati i AAK-së për këshilltar

komune, Veton Uka, ka theksuar rëndësinë e aktivizimit të aeroportit bujqësor dhe spërkatjen e maleve me pesticide kundër sëmundjeve, si dhe kundër shumëzimit të insekteve. Ai e vuri theksin të degradimit dhe dëmtimi i pyjeve dhe ngriti problemin e ndërtimeve të egra në tokat bujqësore.

Gëzim Kllokoqi, nga OJQ "Agro-Eko", ka theksuar rëndësinë e pastrimit jo vetëm të shtratit të lumit Mirusha, por edhe ujit të tij, në të cilin derdhen shumica e ujërave të zeza të Gjilanit. Ai përmendi edhe rëndësinë e ndërtimit të një kolektori për trajtimin e ujërave të zeza dhe një mini-fabrike për riciklimin e ujërave të zeza. Ramadan Mehmeti nga OJQ "Agrofarm", kandidat i AKR-së për këshilltar komune, ka bërë thirrje për një planifikim më të mirë, sidomos të zhvillimit rural dhe investim më të madh në zonat rurale, që do të ndikonte në migrim më të ulët të popullsisë nga fshatrat drejt qytetit. Qëllimi i këtij debati, sipas Shqipe Pantinës, drejtoreshë e QPA-së, është që partitë politike t'i shpalosin platformat e veta zgjedhore në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe planifikimit hapësinor, por edhe të marrin rekomandime e sugjerime nga shoqëria civile dhe zyrtarët për mbrojtjen më të mirë të mjedisit dhe për ndërtim më të mirë të urbanizmit.

